Kronikë

Korçë, shpërthen granata në oborrin e një vile! Të afërmit në konflikt pas vdekjes së pronarëve

Një vilë e pabanuar u sulmua me granatë dore në Bulgarec të Korcës, ku raportohen vetëm dëme të vogla materiale. Shkak dyshohet konflikti për ndarjen e pronës pas vdekjes së pronarëve.

Redaksia
10 Mars, 09:27 | **Përditesimi: 10 Mars, 11:58**

Në oborrin e një vile të pabanuar në Bulgarec të Korçës ka shpërthyer një granate dore, duke shkaktuar vetëm dëme të vogla materiale. Shtëpia ishte e pabanuar prej 4 vitesh, pasi pronari Qazim Leshnja dhe bashkëshortja e tij kanë ndërruar jetë dhe nuk kanë lënë fëmijë.

Fqinjët tregojnë se për mirëmbajtjen e vilës kujdesej motra e të ndjerit Qazim Leshnja, pasi çifti nuk ka lënë fëmijë.

LEXO EDHE:
Fasulja e Maliqit stok, konkurron produkti i Kazakistanit! Fermerët: Tregtarët e marrin se ka çmim më të ulët! Shefi i 'Bujqësisë': Tregtarët e reklamojnë si vendi

> *"Në fshatin Bulgarec, Korçë, në oborrin e një banese të pabanuar pasi pronarët kanë ndërruar jetë 4 vite më parë, dyshohet se ka plasur një granatë dore. Grupi hetimor po punon për sqarimin e rrethanave të ngjarjes", ka njoftuar policia.*

Pista kryesore e hetimeve është konflikti i pronësisë, pasi të afërmit e Leshnjes nuk bien dakord për ndarjen e pasurisë. Policia ka nisur hetimet për zbardhjen e ngjarjes me sekuestrimin e kamerave të bizneseve dhe pyetjen e familjarëve

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 10:33
Shpërthimi me granatë dore në Korçë, nipi i familjes: S'kemi asnjë konflikt

Nipi i familjes në ndërtesën e të cilëve shpërtheu një granatë dore thotë se janë të tronditur nga ngjarja. Ai shprehet se familja e tij nuk ka asnjë konflikt.

> *"Po kaloja për në punë dhe pashë polici këtu. Pashë çfarë ka ndodhur. Nuk di gjë kush e ka bërë. Jemi të tronditur. S'kemi konflikt me asnjëriin", tha ai.*

K.T./Shqiptarja.com

TAG: Korçë granate bulgarec policia e korcës

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
KQZ rrëzon Berishën dhe njeh PD-në e Bashës për 14 Majin, si e vlerësoni?

Të drejtë Të gabuar Nuk e di

Lajme të tjera

Sherr me thika mes të miturve në një lokal në Pogradec, plagoset një prej tyre! Arrestohet 15-vjeçari, bashkëmoshatari i tij dërgohet te 'Trauma' në gjendje të rëndë
7 Mars, 10:17

Aksident në Korçë, makina përplas këmbësorin! Policia rrethon zonën (VIDEO)
6 Mars, 15:55

'Karnavalet e Korçës', Përmbushet amaneti i Avni Mulës, pas Tiranës shfaqja jehonë edhe në Korçë
Armand Braho
5 Mars, 19:24

Ilir Meta 'nuk lëshon' Berishën: Kandidatet e Primareve do të fitojnë më 14 maj, Edi Rama është në panik
5 Mars, 16:10

U kapën duke vendosur baste sportive me telefon, arrestohen 6 persona në Devoll! Nën hetim njëri prej pronarëve të lokalit
5 Mars, 12:45

Moti merr 'kthesë të re', Korça zbardhet nga reshjet e dëborës
5 Mars, 08:40

Operacion kundër lojërave të fatit në lokalet e Devollit! Policia shoqëron disa persona
4 Mars, 21:11

Arrestohet 60-vjeçari në Pogradec, ishte në kërkim si pjesëtar i një grupi kriminale! Ndihmonte emigrantët që të kalonin ilegalisht kufirin
4 Mars, 12:06

VIDEO/ Borë në pranverë, Dardha e Voskopoja dy destinacionet ku mund të kaloni fundjavën
4 Mars, 10:17

Zjarr në Korçë, flakët shkrumbojnë dy plevicat me bazë ushqimore dhe stallën e bagëtive! Në Sarandë digjet një magazinë, asnjë të lënduar
3 Mars, 13:40

Atmosferë festive, Dita e Verës kremtohet në Korçë! Qytetari: Na pëlqen ta festojmë çdo vit, zjarrin e kemi për mbarësi
Armand Braho
1 Mars, 21:24

Aksident në Korçë, përplasen dy makina, drejtuesi i njërit mjet dhe pasagjeri në spital, jashtë rrezikut për jetën
1 Mars, 20:43

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje